



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	06.04.2022
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0031634/22-2
PËR/ZA/TO:	Znj. Blerina Kastrati - Udhëheqëse e Njesisë së Komunikimit me Publikun /Zyra e Informimit
CC:	Z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Vesa Broja - Kryesuese e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Shkëlqim Ibrahimimi – Kryetar i Grupit Punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallja e diskutimit publik

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të UA Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, Komuna shpallë:

DISKUTIM PUBLIK

Për Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në debatin publik, i cili do të mbahet ditën e **martë**, datë **19.04.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga **14:00**.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e Planit të punës së Kuvendit, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e domosdoshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com ose drejtpërdrejt në Sekretarinë e Kuvendit të Komunës tek Udhëheqësi i Sekretarisë z. Nazmi Jashari (e-mail: nazmi.jashari@rks-gov.net).

Bashkangjitur gjeni Draft-Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 të miratuar nga Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2022, i formuar me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.